



Bordi i Zyrës së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080”;
2. Dispozitat e Nenit 9 të Licencës për Gjenerim të energjisë elektrike-TC Kosova A;
3. Dispozitat e Nenit 9 të Licencës për Gjenerim të energjisë elektrike-TC Kosova B;
4. Kërkesën me shkrim të KEK Sh.A-së të dërguar në ZRRE me datë 09 prill 2008, në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2008, nxori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** kërkesa e KEK SH.A-së- (TC Kosova A dhe TC Kosova B) për emërimin e individëve për operimin e njësive gjeneruese.

1. Sipas Nenit 9 të licencës së KEK Sh.A-Divizioni i Gjenerimi -TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë për obligim të emërojnë një individ(ët) të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse që të jetë përgjegjës për operimin e çdo njësie gjeneruese të përfshirë me licencë. Para emërimit të ndonjë individi të tillë i Licencuari duhet të sigurojë miratimin me shkrim nga ZRRE-ja.
2. Me 09 prill 2008 KEK SH.A ka kërkuar nga ZRRE të aprovojë kërkesën për emërimin **Z. Tefik Krasniqi** - për njësinë gjeneruese të TC Kosova A dhe **Z. Isa Hashani** - për njësinë gjeneruese të TC Kosova B, të cilët janë me përvojë përkatëse për operim të këtyre njësive gjeneruese.
3. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e KEK-ut dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatëve ka aprovuar kërkesën që:

Z. Tefik Krasniqi - të jetë operator për njësinë gjeneruese TC Kosova A dhe

Z. Isa Hashani - të jenë operator për njësinë gjeneruese TC Kosova B.

4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Tefik Krasniqi dhe Z. Isa Hashani

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar